



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 17.12. 2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N -225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Radmila Vujoviq, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rustemi dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Meqë kryetari ishte i zënë me punë mbledhjen e Komisionit e drejtoi z. Hajredin Hyseni, zëvendëskryesues i parë.

Mbledhjen e monitoruan: përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësuesi i KDI-së.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor.

Mbledhjen e kryesoi Hajredin Hyseni - zëvendëskryesues i parë i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Shqyrtimi i petitionit të N. R. nga Istogu,
- 3 Shqyrtimi i shkresës së GP-SLS-së lidhur me zëvendësimin e anëtarit të panelit rekrutues të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e avokatit të popullit,
- 4 Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua me plotësimin e pikës të tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i peticionit të N. R. nga Istogu

Hajredin Hyseni – I përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi se Komisioni e ka në agjendë shqyrtimin e peticionit të ushtruar nga N. R. nga Istogu dhe kërkoi ta merrte fjalën raportuesja dhe të njoftonte Komisionin për përmbajtjen e peticionit.

Prof dr. Nerxhivane Dauti – Komisionin shkurtimisht e njoftoi për peticionin e Nezir R. Bajramit nga Istogu që të shqyrtohet vendimi i Agjencisë Kosovare të Pronës, me të cilin kërkohet lirimi i objektit të banimit, i pronës dhe dorëzimi i tyre nën administrimin e AKP-së. Tha se me kujdes e ka shqyrtuar ankesën dhe ka konstatuar se Komisioni nuk është në gjendje t'i japë përgjigje ankuesit për dy çështje: E para - Qeverisë së Republikës së Kosovës i mungon Ligji për nacionalizimin dhe nuk hyrë në strategjinë afatmesme legjislative. E dyta - ankuesi ka kërkuar nga gjykata kompetente ta vërtetojë të drejtën e pronësisë. Nga këto të dhëna Komisioni nuk mund të ofrojë përgjigje përkatëse, prandaj i rekomandon Gjykatës të kërkojë përsheptimin e shqyrtimit të padisë dhe njëkohësisht të informojë në cilin stad gjendet lënda.

Ibrahim Makolli – Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësës theksoi se ky shembull do të na shërbente si rast për të kërkuar nga Qeveria e Kosovës të hartohet Projektligji për nacionalizimin e tokave. Ne vazhdim ceku se ish-sistemi monist pronarë e tokave i ka zhveshur nga e drejta e pronësisë gjatë viteve 1945 -1946 dhe 1947. Ish - sistemi në fushën e marrëdhënie pronëso- juridike u ka shkaktuar pasoja të rënda pronarëve, duke i shpallur penalisht të përgjegjshëm, me epitelin *tradhtarë të popullit*, dhe ua ka konfiskuar tokat. Ishte i mendimit se për këtë Kuvendi i Kosovës duhet ta hartojë ligjin për kompensimin e tokave, sepse ndryshe tokat nuk mund të kthehen.

Hajredin Hyseni – Lidhur me diskutimet e parafolësve u pajtua dhe i propozoi Komisionit të nxjerrë rekomandime përkatëse. U nxorën këto

R e k o m a n d i m e

- 1 *Komisioni i rekomandon Qeverisë së Kosovës ta hartojë Projektligjin për tokat e konfiskuara nga ish-sistemi komunist,*
- 2 *Komisioni kërkon nga Agjencia Kosovare e Pronës t'i ketë parasysh shqetësimet e pronarëve në procesin të privatizimit,*
- 3 *Komisioni të kërkojë nga Gjykata Komunale informata se çka është ndërmarrë deri më tani lidhur me padinë e N. R. nga Istogu,*
- 4 **Shqyrtimi i shkresës së GP-SLS-së për zëvendësimin e anëtarit të panelit rekrutues të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e avokatit popullit.**

Hajredin Hyseni – I njoftoi për shkresën me të cilën kërkohet zëvendësimi i Branislav Gerbiqit me Dragan Dimiqin për anëtar të panelit rekrutues të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e avokatit të popullit. Komisioni e nxori ket

Perfundim

Komisioni e mbështeti kërkesën e GP-SLS-së që Dragan Dimiqi të jetë anëtar i grupit të panelit rekrutues të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e avokatit të popullit.

4 Të ndryshme

Hajredini Hyseni – E vlerësoi punën njëvjeçare të Komisionit dhe vuri në pa se gjatë kësaj kohe ka pasur rezultate në fushën e peticioneve, por në fusha të tjera nuk kemi arritur t'i kryejmë punët sipas planit operativ, si p.sh.: në fushën e barazisë gjinore dhe të personave të pagjetur, në të cilën pati ngecje objektive. Mirëpo në vitin e ardhshëm do të jemi më aktivë për atë sa lejojnë kushtet objektive.

Ibrahim Makolli – Punën njëvjeçare të Komisionit, veçmas në fushën e peticioneve dhe të ligjeve të Pakos së Ahtisarit, e vlerësoi pozitivisht. Për çështjen e personave të pagjetur ka pasur ngecje për shkak se nuk kishte ligj përkatës. Duke folur për ngecje në këtë fushë tha se për to janë përgjegjëse institucionet ndërkombëtare, që nuk ishin në nivel të duhur dhe se pasiviteti i tyre po reflektohet. Duke folur për raportin e BE-së, tha se në të flitet për të gjeturat, se gjoja ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës nuk u janë nënshtruar standardeve evropiane, as nuk janë harmonizuar me Acquis communautaire. Shkurtimisht foli për rëndësinë e Komisionit për të Drejtat e Njeriut që e ka në parlamentet evropiane dhe kërkoi të jetë funksional për të gjitha projektligjet, si dhe të japë mendime ngase i rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Nerxhivane Dauti - E mori për shqetësim paraqitjen në media të disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nga e cila del se në Kosovë ka dhunë familjare ndaj grave dhe fëmijëve, pa argumente dhe pa mendimin e ekspertëve të fushave përkatëse. Ajo u sugjeroi atyre që në deklarata të jenë të kujdesshëm dhe vlerësimet të mbështeten në ndonjë burim shkencor ose në statistika, në të cilat jepen të dhëna për shkelje të të drejtave. Duke u ndërlidhur me opinionet e tyre tha se në të gjitha dispozitat e ligjeve, sidomos me dispozitat e Ligjit të Familjes, e kemi mbrojtur barazinë gjinore. Pra, në të kaluarën, edhe në kanune, gruaja gëzonte mbrojtje juridike e le më tani. Prandaj i sugjeroi Komisionit për Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione ta organizojë një tryezë dhe t'i ftojë aktorët e OJQ-ve, të grupit joformal të grave dhe shoqërinë civile që bashkërisht të debatojmë për këtë dukuri të shëmtuar, ngase me këto veprime të pakujdesshme po krijohen pamje negative për shoqërinë, që nuk i dëshirojmë. Prandaj, ajo që u trajtua në atë emision, nuk i përgjigjet realitetit objektiv, sepse familja është e mbrojtur me ligj.

Naim Rustemi - Duke folur për punën njëvjeçare të Komisionit tha se ka pasur përpjekje, por edhe stangime në hallkat më të rëndësishme. Në fushën e barazisë gjinore e zuri në gojë Agjencinë për Barazi Gjinore, që ka tre vjet që ka mbetur me ushtrues të kryeshefit. Pyeti se cilat janë veprimet e Komisionit për rastin e zgjedhjes së avokatit të popullit? Konsideroi se veprimi i Kuvendit të Kosovës nuk ishte i mirë, as në pajtueshmëri me rregullat e përzgjedhjes së kandidatëve. Adresoi kritika në fushën e të pagjeturve, duke nxjerrë vetëm konstatime. Lidhur me peticionet, përkundër rezultateve pozitive, kanë mbetur të pashqyrtuara disa peticione që i prekin interesat e qeveritarëve. Ua kujtoi të pranishmëve se Komisioni ka vendosur të mbahet një takim me kryetarin Komunës së Prishtinës dhe me rektorin e Universitetit të Prishtinës për ta shqyrtuar peticionin, por deri tani nuk u mbajt. Ai kërkoi që në të ardhmen të bëjmë punë konkrete, e jo vetëm ta plotësojmë numrin e mbledhjeve. Po të punonim, këto

probleme që u vunë në pah nga parafolësit nuk do t'i kishim dhe nuk do t'i lejonim të tjerët të flasin për çështjet e fushës së Komisionit.

Luljeta Shehu – Pati vërejtje se Komisioni nuk i ka realizuar vizitat në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë dhe në Kroaci. Vizitat do të kishin karakter studimor dhe për se afërmi do të informoheshim për përvojat e tyre, që disa janë identike, siç është ajo e personave të pagjetur në Bosnjë. Do të kishim njohuri se si kanë vepruar ata për raste të këtilla. Ne i kemi afër 500 mostra, që nuk u përkasin personave dhe nuk janë në përputhje me legjislacionin e kësaj fushe. Ne fund duke e komentuar përgjigjen e pyetjes, që kohë më parë e mori nga Kuvendi i Kosovës, shprehu shqetësim për përgjigjen. Njëherazi tha se, në mesin në të cilin ajo jeton, është krijuar pakënaqësi për shkak se nuk lejohet rihapja e varrezave.

Drita Maliqi – Kërkoi që për punën njëvjeçare të Komisionit ta kemi një pikë të veçantë. Për atë që u tha këtu për pjesëmarrjen e grave në media theksoi se me Grupin Parlamentar joformal të grave edhe unë kam marrë pjesë si anëtare e grupit të deputeteve dhe si opozitë. Lidhur me këtë është paraparë të zhvillohen 12 emisione.

Mbledhja përfundoi në orën 14.00.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri